



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e katerdhjet e dytë e rregullt e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 24.09.2025, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 10:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

1. Enver Rugova, LDK;
2. Hajrush Shoshi, LDK;
3. Faruk Kabashi, LDK;
4. Haki Podrimaj, LDK;
5. Faik Alushaj, LDK;
6. Ruzhdi Metaj, LDK;
7. Veton Kurtaj, LDK;
8. Arta Balaj, LDK;
9. Liridona Lajçi, LDK;
10. Valbona Demaj, LDK;
11. Njomza Demaj, LDK;
12. Arianit Selmanaj, LDK;
13. Agron Gashi, AAK;
14. Ardita Idrizaj, AAK;
15. Fjolla Ukaj, AAK;
16. Ajshe Metaj, AAK;
17. Negjdet Ramaj, AAK;
18. Florin Dreshaj, VV;
19. Niman Beqiraj, VV;
20. Arian Shatri, VV;
21. Florianax Maxharraj, VV;
22. Lavdiqe Bujupaj, VV;
23. Visar Haxhijaj, PDK;
24. Era Visoqi, PDK;
25. Andi Xhuraj, PDK;
26. Djula Karisik, GIBI;

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm Kryetari i komunës Ilir Ferati, NënKryetari i Komunës Ali Nimanaj Drejtorët e Drejtorive, zyrtarë administrativ si dhe media lokale RTV - Fontana ,përfaqësues të GIZI-it (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverballi dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-te e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar dhe publikuar drejtpërdrejt në

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova.

Kryesuesi i Kuvendit- përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje. Hap punimet për mbledhjen e katerdhjetë të rregullt të Legjislacionit të VII-të dhe për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes në bazë të listës së nënshkrimeve dhe prezencës në sallë, prezentë janë 26 të anëtarë të Kuvendit.

Vazhdojmë me mbledhjen :

R e n d d i t e

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Buxhetit për vitet 2026-2028,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Strategjik për Përfshirje Sociale të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara për periudhën 2025-2027.
5. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit - dua te ju njoftoj që procesverballinnga mbledhja e kaluar nuk kemi mundur ta pergatisim sepse kemi pasur shumë probleme teknike kështu që ju kerkojmi faljen procesverballin do ta keni mbledhjen e ardhshme.

Po ashtu ju njoftoj për piken 4 dhe 5 te cilat propozoj që ti hiqim nga rendi i dites pasi që jemi konsultuar edhe me ministrin që keto dy prona ne nuk do ti rishqyrtojmi të mbeten ashtu.

A ka dikush diçka tjeter rreth ketijë rendi te ditës?

Hedh në votim rendin e ditës për sot, kush është të votohet rendi i ditës me këto propozime?

Konstatohet që nga 26 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 20 vota pro 0 kundër dhe 4 abstenim miratohet rendi i ditës për mbledhjen e sotme.

Shqyrtimi i pikës 1.

Kryesuesi i Kuvendit- Në mbledhje mungon Nexhmedin Balaj.

Të pranishëm në mbledhje janë 26 anëtarë të Kuvendit.

Shqyrtimi i pikës 2.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës shqyrtimi dhe miratimi i procesverbaleve nga mbledhja e kaluar, a ka dikush diçka.

Hedh në votim procesverbalet

Konstatohet që nga 25 anëtarë të Kuvendit të pranishëm miratohen unanim procesverbalet e muajit Korrik dhe Gushtë .

Shqyrtimi i pikës 3.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës: shqyrtimi dhe miratimi i Draft Buxhetit për vitet 2026-2028, Materialin e keni pasur a ka dikudh diçka?

Drejtori për Buxhet e Financa, Zhvillim Ekonomik, z. Genc Ademaj – përshendet të pranishëm bën prezantimin dhe sqarimin e Draft Buxhetit për vitet 2026-2028 .

- Pas shumë diskutimesh nga anëtarët e Kuvendit të komunës dhe sqarime nga Drejtori .

Kryesuesi i Kuvendit hedh në votim Draft Buxhetit për vitet 2026-2028:

Konstatohet që nga 25 anëtarë të Kuvendit të pranishëm me 20 vota pro dhe 5 kundër miratohet Buxhetit për vitet 2026-2028.

Shqyrtimi i pikës 4.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojm me piken e katert të rendit të dites: shqyrtimi dhe miratimi i Planit Strategjik për Përfshirje Sociale të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara për periudhën 2025–2027, Materialin e keni pasur a ka dikudh diqka?

- Pas shumë diskutimesh nga anëtarët e Kuvendit të komunës dhe sqarime nga Drejtori .

Kryesuesi i Kuvendit hedh në votim:

Konstatojmë që nga 23 anëtarë të Kuvendit të pranishëm unanim votohet Plani Strategjik për Përfshirje Sociale të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara për periudhën 2025–2027.

Shqyrtimi i pikës 5.

Kryesuesi i Kuvendit - vazhdojm me piken e fundit të rendit të dites të ndryshme:
A ka dikush diqka.

Dua te ju falenderoj për bashkpunim dhe për keto 4 vite rrugetim së bashku.

Ju uroj sukesë të gjithëve në zgjedhje pasi që kjo është mbledhja e fundit për këtë legjislacion.

E shpallë të mbyllur mbledhjen.

Faleminderit për pjesëmarrje, dhe kontributin tuaj.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 11:55

**Procesmbajtëse,
Vjosa Hysenaj**

**Kryesues i mbledhjes,
Enver Rugova**